



Implemented by:



MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE



AGJENCIA E PUNËSIMIT
AGENCIJA ZA ZAPOSŁJAVANJE
EMPLOYMENT AGENCY

WYG savjetovanje d.o.o.
part of the WYG group



PËRKRAHJE PËR MINISTRINË E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE PËR IMPLEMENTIMIN EFIKAS DHE EFEKTIV TË MASAVE AKTIVE PËR TREGUN E PUNËS
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE FOR EFFICIENT AND EFFECTIVE IMPLEMENTATION OF ACTIVE LABOUR MARKET MEASURES
PODRSKA MINISTARSTVU RADA I SOCIJALNE ZASTITE ZA EFIKASNO I EFEKTIVNO SPROVODENJE AKTIVNIH MERA TRZISTA RADA

Buletin

Prishtinë | Numri i tretë | Prill 2020

Përkrahje për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Implementimin Efikas dhe Efektiv të Masave Aktive për Tregun e Punës

Tregu i punës në Kosovë po përballet me shumë sfida. Projekti “Përkrahje për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për Implementimin Efikas dhe Efektiv të Masave Aktive për Tregun e Punës” është projekt 42-mujor, që financohet në kuadër të Instrumentit për Para-anëtarësim II (IPA) dhe zbatohet nga WYG savjetovanje d.o.o., me synimin për t’i asistuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Agjencisë për Punësim që t’i adresojnë këto sfida. Projekti është pjesë e përpjekjeve më të zgjeruara dhe gjithëpërfshirëse të MPMS-së, Agjencisë për Punësim për të modernizuar shërbimet e veta. Projekti është dizajnuar për të fuqizuar kapacitetet e MPMS-së dhe Agjencisë për Punësim dhe palëve të tjera të interesit (p.sh., përfituesit e granteve) që të përcaktojnë benefitet dhe zgjidhjet për problemet me të cilat përballen në tregun e punës grupet e pafavorizuara, sidomos të rinjtë dhe gratë.

Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të rrisë punësueshmërinë dhe perspektivën për punësim të qëndrueshëm për grupet e pafavorizuara, sidomos të rinjtë dhe gratë në Kosovë. Qëllimi i projektit është “zhvillimi i kapaciteteve të MPMS-së dhe Agjencisë për Punësim që të implementojnë dhe monitorojnë masa aktive për tregun e punës me fokus tek grupet e pafavorizuara, sidomos të rinjtë dhe gratë”.

Të reja nga projekti

Projekti është tashmë në vitin e tretë të implementimit dhe ka arritur sukses të konsiderueshëm drejt përmbushjes së objektivit të përgjithshëm dhe rezultateve të pritshme. Pandemia e COVID-19 pengoi implementimin e patrazuar të projektit dhe shumë nga aktivitetet u rifokusuan ose u shndërruan në aktivitete virtuale. Projekti ka 2 rezultate kryesore të projektit: Rezultati 1: MPMS, Agjencia për Punësim, autoritetet lokale dhe partnerët socialë janë pajisur me shkathtësitë për të hartuar veprime konkrete në kuadër të masave aktive për tregun e punës (MATP) në sektorin e punësimit, arsimit dhe zhvillimit social. Rezultati 2: MPMS dhe Agjencia për Punësim janë pajisur me njohuri dhe përvojë në implementimin dhe monitorimin e MATP-ve të propozuara për grupet e pafavorizuara, sidomos për të rinjtë dhe gratë.

PËRMIRËSIM I SHËRBIMEVE DHE I KOORDINIMIT

Është zhvilluar lista e projekteve me prioritet në sektorin e punësimit, arsimit dhe gjithëpërfshirjes sociale

Ky aktivitet u implementua nëpërmjet përkrahjes që iu dha Grupit Këshillimor për Përgatitjen e Projektit (GKPP) dhe u zhvilluan gjashtë projekte me prioritet që mund t'u paraqiten donatorëve për përkrahje në të ardhmen. GKPP-ja shërbeu si platformë për shkëmbim të ideve për dizajnim praktik të projekteve. Këtu, anëtarët vlerësuan cilësinë e linjës ekzistuese dhe mblodhën, organizuan dhe renditën projektet sipas prioriteteve. Këto projekte janë me relevancë për MATP-të në sektorët e punësimit, aftësisimit profesional dhe gjithëpërfshirjes/aktivizimit social, që prekin grupet e pafavorizuara, sidomos të rinjtë dhe gratë. U finalizuan gjashtë projektet e linjës së vijim:

- Decentralizimi i Social,
- Skema e Granteve për Skema Sociale,
- Zhvillimi i Politikave për Punësim,
- Përkrahje për kapacitetet e DPP-së dhe Agjencisë për Punësim për aftësim profesional të mirëinformuar dhe të targetuar në partneritet me sektorin privat,
- Ekosistemi i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë së të Rinjve përmes Qendrave Rinore Komunale, dhe
- Zhvillimi i sektorit të Ndërmarrjeve Sociale.



Trajnim për MPMS-në dhe Agjencinë për Punësim që të dizajnojnë, zhvillojnë, implementojnë dhe monitorojnë MATP-të për grupet në nevojë

Trajnimi synonte të ndërtonte kapacitetet në menaxhimin strategjik për zhvillim të politikave, dizajnim të projekteve dhe implementim për: Agjencinë për Punësim, MPMS-në, Qendrat për Punës Sociale, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (Ministrinë, Qendrat Rinore dhe Këshillet Rinore), OJQ-të dhe komunat lokale. U trajnuan 142 persona përmes një sërë prezantimesh, diskutimesh, grupesh punuese dhe duke përdorur shembuj nga jeta reale. Trajnimi përfundoi në janar 2020.

Fuqizimi i kapaciteteve në MPMS dhe Agjencinë për Punësim për të ofruar MATP efektive dhe efikase për grupet në nevojë.

Zhvillimi i listës së projekteve me prioritet në sektorin e punësimit, arsimit dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Me mbështetje nga projekti, është zhvilluar legjislacioni sekondar që ka të bëjë me Ligjin Nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale dhe Qeveria ka miratuar katër Udhëzimet Administrative të para.

Janë zhvilluar gjashtë Udhëzime Administrative

Bashkë me grupin punues të përbërë nga stafi i ministrive, u zhvilluan gjashtë Udhëzime Administrative për të mbështetur zbatimin e Ligjit për Ndërmarrje Sociale.

- Procedurat për regjistrimin e Ndërmarrjeve Sociale,
- Procedurat për arritjen e objektivave sociale dhe raportet financiare,
- Procedurat dhe dokumentacioni i nevojshëm për të dhënë, refuzuar ose tërhequr statusin e Ndërmarrjes Sociale dhe përbërja e komisionit përkatës ministror,
- Afati për pagesën e gjobave, procedurat dhe ankesat,
- Ndryshimi dhe plotësimi i fushave të aktiviteteve të ndërmarrjeve sociale të kategorive A dhe B, dhe
- Ndryshimi dhe plotësimi i kategorive të tjera të personave me aftësi të kufizuara dhe integrimi i tyre në tregun e punës.

Projekti po përmbush me sukses objektivat e planifikuara dhe po ndikon pozitivisht në mjedisin e punës në Kosovë.

Doracak për Ndërmarrjet Sociale

Është zhvilluar një Doracak për të mbështetur Njësinë për Ndërmarrje Sociale të MPMS-së dhe komisionet që pritet të krijohen nëpërmjet Udhëzimeve Administrative, si dhe ato organizata në Kosovë që dëshirojnë të regjistrohen dhe të operojnë si Ndërmarrje Sociale.

Plani për Ngritjen e Kapaciteteve dhe Trajnime për ndërmarrjet sociale

Është zhvilluar Plani për Ngritjen e Kapaciteteve dhe Trajnime për ato organizata që kanë përgjegjësi/rol në zhvillimin e ndërmarrjeve sociale në Kosovë.

Njësia për Ndërmarrje Sociale

Ekipi i projektit ka zhvilluar dokumentacionin mbështetës për zhvillimin e Njesisë për Ndërmarrje Sociale brenda MPMS-së.

VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË AGJENCISË PËR PUNËSIM

Ka përfunduar puna edhe për Vlerësimin e Kapaciteteve të Agjencisë për Punësim. Plotësimi i vlerësimit përfshiu hulumtim nga zyra për dokumentat kyçe, plotësimi i një pyetësori nga secili divizion i Agjencisë për Punësim dhe shqyrtim i thelluar i SMIP.

U shqyrtuan këto çështje: struktura e sektorit të punësimit; korniza ligjore dhe roli i ministrisë dhe i agjencisë; struktura organizative; sistemi i menaxhimit; financimi dhe buxhetimi; kapacitetet organizative dhe teknike të shërbimeve të punësimit dhe aftësimin; menaxhimi operativ i proceseve kryesore të punës lidhur me qasjen ndaj grupeve të targetuara, shërbimeve për punëdhënës, ofrimin të shërbimeve; çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e cilësisë dhe sisteme të matjes së performancës; dhe indikatorët dhe raportimin (statistikat, mbledhja e të dhënave, sistemi i informacionit).

Puna u mbikëqyr nga Grupi Punues i Agjencisë për Punësim që u caktua dhe gjatë fazave kyçe u prezantuan drafte të raporteve. Drafti final i raportit iu paraqit më 17 dhjetor 2019 Agjencisë për Punësim dhe GIZ-it, me të cilët ekipi i projektit ka punuar së afërmi gjatë implementimit.

Më 17 prill 2020 Drejtori i Përgjithshëm miratoi Raportin për Vlerësimin Funkcional.

Rekomandimet kryesore për Agjencinë për Punësim ishin:

- Ristrukturimi i organizatës;
- Zhvillimi i shërbimeve për klientë – të papunësuar dhe punëdhënës;
- Zhvillimi i stafit – edukimi i stafit të Agjencisë për Punësim;
- Menaxhimi i të dhënave për operacione dhe asete;
- Sistemi për menaxhimin e performancës – zhvillimi i partneriteteve lokale me palë të interesit në të gjitha nivelet;
- Sigurimi për papunësinë; dhe
- Anketimi i klientëve.

Përkrahje Për Agjencinë për Punësim dhe MPMS për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve

Skema e granteve “Përkrahje për Aftësimin Profesional, Aftësimin në Vendin e Punës, Vetëpunësimin dhe Ndërmarrësinë” u përdor për të lehtësuar rritjen e kapaciteteve të MPMS-së dhe Agjencisë për Punësim për të monitoruar dhe vlerësuar këto projekte nga skemat e granteve dhe të tjera në të ardhmen dhe MATP-të. Nisi puna për ngritjen e kapaciteteve të 40 Zyrtarëve për Monitorim të MPMS-së dhe Agjencisë për Punësim dhe deri në dhjetor 2019 u bë e mundur përfundimi i raundit të parë dhe të dytë të vizitave monitoruese tek gjashtë përfitues të granteve. Për shkak të kufizimeve nga COVID-19, vizitat monitoruese të planifikuara për shkurt 2020 u pezulluan.

Në janar 2020 u prezantuan Raportet Vjetore të implementimit. Këto raporte i ndihmojnë Agjencisë për Punësim dhe MPMS-së të hartojnë dhe të analizojnë informacionin nga monitorimi për të prezantuar përmbledhje të qarta, tërësore dhe të azhuruara që mundësojnë vijimësinë e duhur të programeve në përputhje me objektivat dhe caqet sipas rregulloreve të IPA-s.

- Edhe pse të gjashtë projektet brenda Skemës së Granteve “Përkrahje për Aftësimin Profesional, Aftësimin në Vendin e Punës, Vetëpunësimin dhe Ndërmarrësinë” ende nuk kanë përfunduar, mbi 1,200 persona që u përkasin grupeve të targetyara nga skema e granteve janë trajnuar, arsimuar, kanë marrë arsimim në vendin e punës dhe nën-grante.
- Në vitin 2019, mbi 1,019 pjesëtarë nga grupet e targetuara janë trajnuar. 86 biznese fillestare kanë marrë përkrahje financiare nëpërmjet hapësirës së inkubatorit, këshillave nga ekspertët dhe trajnimet. 70 ekspertë janë trajnuar. Puna praktike me pagesë/afësimi në vendin e punës dëshmoi të jetë efektiv.
- U zhvilluan praktika të mira për partneritete me Zyrat Rajonale për Punësim, Komunitetet dhe palë të tjera të interesit.



ÇFARË PO BËJMË

Për shkak të pandemisë globale dhe për pasojë, vonesave në implementimin e projektit, më 22 gusht 2020 periudha për implementimin e projektit u shty deri më 21 nëntor 2021.

Implementimi i projektit nga 22 gushti 2020 deri më 21 nëntor 2021

Zgjatja fokusohet tek: përkrahja për Agjencinë për Punësim dhe MPMS-në për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve dhe Vlerësimi Kundërfaktik i Ndikimit të MATP-ve.

PËRKRAHJE PËR AGJENCINË PËR PUNËSIM DHE MPMS-NË NË MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E PROJEKTEVE

Në vijimë të zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve të 40 Zyrtarëve Monitorues të Agjencisë për Punësim dhe MPMS-së, përmes monitorimit të 14 përfituesve të rinj të skemës së granteve përmes skemës së granteve “Përmirësimi i qasjes në tregun e punës për grupet e pafavorizuara nëpërmjet ndërmarrjeve sociale dhe masave aktive për tregun e punës”.

Më 1-2 prill 2021, ekipi i projektit mbajti një trajnim dy-ditor për 14 përfituesit e skemës së granteve (20 pjesëmarrës) për t’iu prezantuar kornizën institucionale dhe ligjore për implementimin e

granteve të BE-së, praktikatat e mira për menaxhimin e projekteve nga grantet, rregullat për komunikim dhe planet e komunikimit për projektet e tyre, kërkesat raportuese për projekte të financuara nga BE-ja dhe procedurat për prokurim dhe nën-grantim.

Më 26 prill 2021, ekipi i projektit mbajti trajnim për rifreskim të njohurive për 35 Zyrtarë Monitorues të Agjencisë për Punësim. Ata më herët ishin trajnuar për monitorimin e skemave të granteve për MATP dhe kishin monitoruar në mënyrë aktive implementimin e 6 përfituesve të skemës së granteve të mbështetur

përmes skemës së granteve të ZBEK-së “Përkrahje për Aftësimin Profesional, Aftësimin në Vendin e Punës, Vetëpunësimin dhe Ndërmarrësinë”. Për pjesëmarrjen në trajnim dhe punën e bërë në projekt deri më tani, Zyrtarët Monitorues morën certifikata.



WHAT WE ARE DOING

Vlerësimi i Ndikimit Kontraktual

Përkrahje për implementimin e Vlerësimit Kundërfaktik të Ndikimit të MATP-ve në Kosovë për të parën herë. Ky mjet po përdoret gjithnjë e më shumë nga Komisioni Evropian për të vlerësuar ndikimin e programeve. Gjatë analizës kundërfaktike, arritjet e intervenimeve specifike, si për shembull MATP-ve, krahasohen me arritjet që do të ishin arritur nëse intervenimi nuk do të ishte implementuar, për të përcaktuar efektin neto të masave. Për t'i identifikuar arritjet në mungesë të intervenimit, krijohen grupe të trajtimit dhe kontrollit.

- Grupet e trajtimit përbëhen nga të gjithë individët që morën pjesë në intervenim, p.sh., që morën pjesë në MATP, brenda një periudhe të caktuar, p.sh., përgjatë tre viteve; dhe
- Grupi i kontrollit përfshin individë të pranueshëm për masat me karakteristika shumë të ngjashme me ata të grupit të kontrollit; vetëm se ata nuk e kanë përjetuar ndikimin e intervenimit – nuk kanë marrë pjesë në MATP. Arritjet e grupit të kontrollit na mundësojnë të identifikojnë arritjet që grupi i trajtimit të kishte arritur pa intervenimin, me fjalë të tjera, ndikimin neto të masës. Aktualisht, po vijon puna për të dizajnuar metodologjinë, edhe përzgjedhjen e masave dhe programeve që do të përfshihen.